

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Akte të Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike

Vëllimi II *Gjuhësi dhe antropologji*

Përgatitën botimin:

Shaban Sinani
Pëllumb Xhufi

Aktet e Kuvendit Ndërkombëtar të Studimeve Albanologjike botohen
nën kujdesin e akad. **Skënder Gjinushi**, Kryetar i Akademisë së
Shkencave

Tiranë 2022

Tryeza e lëndës

I. Gjuhësi	9
• Sergio Neri Zur Wortbildung und Etymologie von alb. (i) <i>rī</i>, jung; neu‘, <i>kā</i>, haben‘, <i>kruo</i>, Quelle; Brunnen‘, <i>zē</i>, ergreifen‘ und <i>ȳll</i>, Stern‘	11
• Irena Sawicka Shqipja - një pasqyrë e fazave universale të zhvillimit të rrokjes	29
• Simona Marchesini Linguistic relations between Messapia and Illyria: the state of the art Leonardo Maria Savoia	37
• Leonardo Maria Savoia, Benedetta Baldi Verb constructs in Shkodër Gheg: morphosyntax of bare bases.....	63
• Olav Hackstein Prevervation in Albanian in historical perspective	89
• Mario de Matteis Tracce linguistiche comuni tra il messapico e l'albanese	102
• Bahri Beci Bashkësia gjuhësore ballkanike në dritën e të dhënave të gjuhës shqipe	112
• Bardhyl Demiraj, Anila Omari Leksiku historik i gjuhës shqipe (shek. XV-XVIII) në fokusin e përpunimit filologjik-etimologjik bashkëkohor.....	125
• Rexhep Ismajli Idetë për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve në Jugosllavi	154
• Nelson Çabej Kontribut për evolucionin e disa emrave ilirë të vendeve.....	176

• Anton Pançev Bashkëpërkimet gjuhësore bullgaro-shqiptare gjatë Rilindjes	192
• Ethem Likaj Për formimin e dëshirores së shqipes.....	204
• Giuseppina Turano, Flora Koleci Analizë dhe riklasifikim i disa ndërtimeve sintaksore sipas parimeve të gramatikës gjenerative	217
• Maria Morozova, Aleksandër Rusakov, Maria Ovsjannikova Studime të dialekteve të gjuhës shqipe: metoda dhe prurje të reja	247
• Aristotel Spiro Prokliza binare dhe enkliza shqese: dy anë të të njëjtit proces evolutiv gramatikalizues në shqipe.....	267
• Tomorr Plangarica Mbi nevojën e shqyrtimeve më të thelluara në disa kahe të interesimeve të gjuhësisë së zbatuar për shqipen në periudhën e tanishme.....	283
• Ali Jashari Shtresa e idiomave ndërgjuhëshe në ligjërimin e shkruar të shqipes	308
• Eleni Bantiou Albanian-Greek phraseological isoglosses in Epirus.....	337
• Aljula Jubani Mbi prirjet e normës fonetike të shqipes së sotme	349
• Mimoza Priku Rasti i leksikut vetjak autorial dhe perspektiva të reja të leksikografisë shqipe.....	363
• Mimoza Kore Vështrim mbi leksikun dituror në veprën e Francesco Maria da Lecces “Dittionario Italiano-Albanese”	375
• Kristina Jorgaqi Pionierët e mendimit mbi shqipen e përbashkët	388

• Adelina Çerpja, Anila Çepani Shqipja në erën digjitale - arritje dhe perspektiva	407
• Nexhip Mërkuri Kujtesa historike e toponimeve në rrjedhë të kohërave: vështrim historiko- krahasues rreth toponimisë së Përmetit	438
• Enkeleida Kapia Sintaksa dialektore e shqipes: të dhëna të reja dialektologjike dhe sociolinguistike	462
• Manjola Lubishtani Funksionet e markerit riformulues “pra” në gjuhën shqipe	478
• Gilberta Hadaj Mbikarakterizimi morfologjik në sistemin emëror të gjuhës shqipe	490
• Begzad Baliu Probleme të metodës së kërkimit të onomastikës në Kosovë	515
• Esmeralda Strori Terminologjia e informatikës në gjuhën shqipe: gjendja e sotme	540
II. Antropologji	551
• Genc Sulçebe Studimi i polimorfizmit gjenetik të “kompleksit madhor të pajtueshmërisë indore” (HLA) në popullatën shqiptare dhe impakti i tij në analizën e distancave gjenetike midis shqiptarëve dhe popullatave të tjera europiane	553
• Eno Koço Fan S. Noli and music	569
• Holta Sina Kilica Shkrimi muzikor ekfonetik në dy kodikë të AQSH-së dhe në një kodik të Rumanisë, vështrim krahasues	609
• Jane C. Sugarman Youth Culture and Grassroots Musics in Late Socialist Kosova	623
• Shaban Sinani Identifikime mesjetare europiane në eposin shqiptar përmes etnonimeve	641

• Kosta Lolis Mbijetesa e këngës arvanitase në Greqi: vështrim historiko-artistik.....	679
• Zymer Neziri Eposi i kreshnikëve në pesë shtete të Ballkanit: gjendja në fillim të shekullit XXI.....	687
• Vasil S. Tole Vajtimi dhe gjuha shqipe e kënduar: gjinitë dhe fjalët e urta për vajtimin.....	722
• Andrea Shundi, Nazim Gruda Ushqimi në lashtësi dhe sot, dëshmi jetese ndenjëtare dhe e qytetërimit	732
• Panajot Barka Eposi heroik shqiptar në raport me vetveten dhe të tjerët	738
• Albana Velianj Mendësi të një stadi parafamiljar në disa rite tradicionale shqiptare	756
• Arbnora Dushi, Olimbi Velaj Balada e murimit në kontekst ndërballkanik: çështja e origjinës nën dritën e disa interpretimeve.....	766
• Nazim Gruda, Andrea Shundi Bujqësia, dëshmi e kulturës së lashtë shqiptare.....	782

Bardhyl Demiraj

LMU

Anila Omari

Shqipëri

Leksiku historik i gjuhës shqipe në fokusin e përpunimit filologjik-etimologjik bashkëkohor

Abstract

Already by its title, this presentation gets the auditory acquainted to the object as well as to the goals that we have set ourselves with the selected topic, and also to the scientific and methodical apparatus which is necessary for its successful development.

In other words, the title touches the peculiarity as well as the extent of the work which directly goes along with, or might even be the condition for the main study, which has to do with the linguistic-philological and etymological gathering, organization, classification and analysis of the historical lexicon of the Albanian language, in exactly the way in which we sample this lexicon as a part of the early culture of Albanian writing (15th – 18th century) that we know and inherit until today.

By ignoring in the title at least – and as it is to be expected in such a case – the period of time of such a project, we also want to add in advance that this presentation is not any way designed to unroll to the auditory some general theoretic-methodic considerations and criterions, of how in the possibly near future the historic lexicon of Albanian can and must be treated and studied, but rather and even mainly to present those specific work steps that are meanwhile conceived and taken in the realization of the long-term project “Digital Philological-Etymological Dictionary of Old Albanian” i. e. “Digitales, philologisch-etymologisches Wörterbuch des Altalbanischen”, 2018-2024 (<<https://www.dpwa.gwi.uni-muenchen.de/>>), that is directed by the Albanological Center of the Ludwig Maximilian University of Munich (1. Modul – Demiraj; 2. Modul – Hackstein).

1 Fjalë hyrëse

Në këtë kumtesë i përcjellim auditorit qysh në titull si objektin ashtu edhe qëllimet që syzohet me temën e përzgjedhur prej nesh, sikurse edhe aparatit shkencor dhe metodik që parakupton zhvillimin e saj të suksesshëm. Thënë ndryshe, titulli rrok njëherësh specifikën dhe vëllimin e punës që përkon pandërmjetshëm, në mos kushtëzohet tërësisht me atë studim ballor që ka të bëjë me qëmtimin, organizimin, klasifikimin dhe analizën gjuhësore-filologjike dhe etimologjike të leksikut historik të gjuhës shqipe, bash ashtu siç e ngjetojmë atë të fiksuar në kulturën e hershme të shkrimit shqip (shek. XV-XVIII) që njohim dhe trashëgojmë deri sot. Gjithashtu lejohemi të shtojmë paraprakisht që kjo kumtesë nuk është konceptuar asses si e tillë, me i përcjellë auditorit do konsiderata e kritere të përgjithshme, se si mund a do rrokur e studiuar në një të ardhme sado të afërt leksiku historik i gjuhës shqipe, se sa, madje sidomos, të përcjellë në diskursin albanologjik ato hapa dhe punë konkrete që janë verifikuar e ndërmarrë ndërkohë në realizimin e projektit afatgjatë *Fjalor filologjik-etimologjik i shqipes së vjetër* (shek. XV-XVIII) (“Digitales, philologisch-etymologisches Wörterbuch des Altalbanischen (XV.-XVIII. Jh.)” <<https://www.dpwa.gwi.uni-muenchen.de/>>), të cilin e drejtojnë jo rastësisht dy qendra shkencore-universitare në albanologji (Prof. dr. Bardhyl Demiraj) dhe indoeuropianistikë (Prof. dr. Olav Hackstein) në universitetin elitar Ludwig-Maximilian të Mynihut (RFGJ) e që gëzon mbështetje të fuqishme infrastrukturore prej fondacionit po aq elitar gjerman “Deutsche Forschungsgemeinschaft” (DFG).

Prashtu, në vijim të këtyre fjalëve hyrëse do të ndalemi thukët si në konceptimin dhe organizimin ashtu edhe në fazat e ndryshme të realizimit të këtij projekti, duke u fokusuar këtu sidomos në pjesën e tij të parë (Moduli I – Demiraj), pikërisht në atë që ka të bëjë me përpunimin filologjik-digjital të materialit gjuhësor, e në këtë mënyrë të kumtojmë njëherësh atë çka bashkëlidh prurjet e derisotme në studimet historike-filologjike në albanologji me ato risi që synojnë të sendërtojnë realisht historinë e fjalës në këtë projekt afatgjatë.

2 Koncepte dhe premisa metodike

2.1 Hapësira kulturore shqiptare si sendërtim i tri arealeve dialektore e kulturore-gjeografike

Rrethanat bashkëkohore që përcjellin lëvrimin e kulturës së hershme të shkrimit shqip në kohë dhe hapësirë kushtëzojnë njëherësh kufizimin qoftë edhe *ad hoc* të përhapjes së saj përgjatë shek. XV-XVIII në tri areale kulturore-gjeografike që përkojnë qoftë edhe pjesërisht me dy hapësira dialektore:

1. A_G : Areali Kulturor i Veriut katolik (= dialekti gegë i Veriut), kundrejt

2. A_T : Areali Kulturor i Jugut ortodoks (= dialekti toskë, së bashku me do të folme të gegnishtes jugore), sikurse

3. A_{AR} : Areali Kulturor Arbëresh në Italinë e Jugut dhe Siçili (= dialekt konservator toskë), ku vepronte atëbotë e në shumësinë e vet edhe sot Kisha Lindore (uniata) e ritit greko-bizantin.

Në varësi me formimin e tyre intelektual-fetar autorët e teksteve shqip në këto areale kanë lëvruar shqipen, duke u mbështetur sipas rastit në alfabetin latinisht/italisht me rregullat e leximit përkatës (A_G), në alfabetin greqisht, në mos duke sajuar një alfabet origjinal (= A_T), ose kryesisht në alfabetin latinisht e herë-herë edhe me shmangie të rastit edhe në atë greqisht (= A_{AR}). Pjesë e veçantë brenda Arealit Kulturor të Jugut shqiptar (A_T) janë gjithashtu edhe prurjet e një numri autorësh të shek. XVIII, që vepronin në rrethe kulturore-intelektuale me orientim islamik-oriental, duke përdorur kështu sipas rastit kryesisht alfabetin arab me rregullat e leximit përkatës.

Jemi të ndërgjegjshëm, që kjo ndarje areale-kulturore treshe përjashton qoftë edhe *ad hoc* një pjesë të madhe të diasporës historike shqiptare (shek. XIV-XVIII), sidomos atë arvanitase në Greqi, ku flitet ende sot në masë të konsiderueshme një toskërishte arkaike, dokumentimi shkrimor i së cilës fillon gjithsesi jo më herët se gjysma e dytë e shek. XIX. Ndër oazet e tjera gjuhësore të diasporës historike shqiptare dëshmohen me shkrim mbledhje sporadike dhe tekste të shkurtra gegnisht në zonën e Istrias dhe në Srem, ku gjuha shqipe përdorej ende në mënyrë sporadike si mjet komunikimi në fund të shek. XIX e fillim të shek. XX.¹ Nuk është rrokur në analizat e mirëfillta tekstuale-filologjike as kultura e shkrimit shqip me alfabet arab në

¹ Windisch 1782; së fundi edhe Altinari 2020 147vv.

Arealin kulturor të Veriut (A_G), ku datimet e teksteve më të hershme shqip i takojnë shek. XIX.

2.2 Leksiku historik i gjuhës shqipe (shek. XV-XVIII)

Me leksik historik të gjuhës shqipe kuptojmë të gjithë fondin leksikor të fiksuar në trashëgiminë e shkrimit shqip brenda një hapësire kohore që përmbyllet qoftë edhe *ad hoc* me fundin e shek. XVIII dhe fillimet e shek. XIX, pikërisht në një periudhë kur kultura e shkrimit shqip, aq sa dhe ashtu siç e njohim deri sot, përmbushte funksione deri diku të kufizuara sociale, që vjen me thënë:

- kryesisht në një qerthull të mbyllur komunikimi brenda qarqesh intelektuale-klerikale që vepronin në hapësirën kompakte shqipfolëse në Ballkan si edhe në diasporën historike italo-arbëreshe të kësaj periudhe¹;

- më rrallë në rrethe të ndryshme shtresash sociale-fetare shqipfolëse²;

- e shumë më rrallë e sipas rastit edhe në ndërkomunikimin me institucionet vendore në këtë hapësirë^{3 4}.

¹ Mund të përmendim këtu ndër të tjera veprat e autorëve të tillë si: Buzuku (1555); Matrënga (Matranga 1592); Budi (1618; 1621a, 1621b) etj.

² Dallojmë ndër të tjera:

a) Katekizma: Matranga 1592; Budi 1618; Figlia 1734; Kazazi 1743 etj.

b) Akte juridike-sinodale: Babbi 1704; Kuvendi i Arbenit 1706.

c) Tekste liturgjike dhe fetare në dorëshkrim, si: perikope, lutje, psalme, himne, veprat e apostujve etj.: Dsh. Ambrosiana (shek. XVI-XVII); Dsh. Chalki (shek. XVI-XVII); Terpo 1731; Anonimi i Elbasanit 1761, Radovani 1776, Kodiku Beratas (shek. XVIII); sikurse edhe:

d) Gramatika, fjalorë dhe glosarë dy- a më shumë gjuhësh që shërbenin për njohjen dhe mësimin shqipes ase të një gjuhe të dytë (edhe) nëpërmjet saj: Arnold von Harff 1476; Bardhi (Blanchus): 1635; Ballovich: 1693; Da Lecce 1702; 1716; Da Desio 1710; Chetta 1763; Kavalioti (Kavalliotis) 1770; Dhanili (Danieli) 1802; Vellaraj 1800 etj.

e) Krijime letrare, folklor: Ufuk 1650; Bogdani 1685; Variboba 1762; Kamberi dhe Frakulla (shek. XVIII); Codice Chieutino (shek. XVIII) etj.

f) Të ndryshme: Formula e mallkimit 1483; Babbi 1704; Leibniz 1709-1711; Guzzetta 1734- (?) etj.

³ P.sh. në korrespondencë: Mazreku 1633; Toliq (*Letra e pleqve të Gashit*) 1689; *Letra e fretërve të Pultit* 1761 etj.

⁴ Në shek. XIX përjetojmë një fazë të re në kulturën e shkrimit shqip, ku mbizotërojnë shkrimet dhe botimet me destinacion shtresat e ndryshme sociale përkatësisht me synime mbarëshoqërore: alfabetizimi dhe zgjimi kombëtar i bashkësisë shqipfolëse, përpunimi dhe purifikimi i vetëdijshëm i gjuhës së shkruar, çka nxiti natyrshëm kalimin e shqipes së shkruar në fazën e saj moderne drejt njësimi mbidialektor. Shih së fundi Demiraj 2017 170vv.

Asgjemangut, në punën tonë për mbledhjen dhe klasifikimin e leksikut historik të shqipes jemi mbështetur fuqishëm në prurjet e konsiderueshme dhe të sigurta që janë arritur deri sot në filologjinë dhe leksikologjinë historike të gjuhës shqipe, ku feksin emra të tillë studiuesish dhe filologësh seriozë si At Justin Rrota, Namik Resuli, Eqrem Çabej, Matteo Sciambra, Martin Camaj, Shaban Demiraj, Gunnar Svane, Jürgen Kristophson, Armin Hetzer, Titos Jochalas, Italo Costante Fortino, Vinçenc Malaj, Robert Elsie etj.¹, e duke vijuar këtë siguri në hulumtim me emra të tjerë filologësh në këta tre dhjetëvjeçarët e fundit, si: Wolfgang Hock, Michiel de Vaan, Matteo Mandalà, Bardhyl Demiraj, Anila Omari, Gëzim Gurga; Francesco Altimari, Genciana Abazi-Egro, Fatos Dibra etj.², një pjesë e të cilëve punën e mirëfilltë ekdotike me përmendore të hershme të shkrimit shqip e ka përmbyllur me pasqyrimin e bashkëpërkimeve (= konkordancave) leksikore në tekstet përkatëse. Punë të lëndueshme e të sigurt konstatojmë së fundi në studime të veçanta mbi fusha dhe shtresa të tëra të leksikut historik të gjuhës shqipe prej një numri studiuesish, ku feks sidomos emri i leksikologut të centë e tejet prodhimtar Kolë Ashta, sikurse edhe i të tjerëve autorë veprash e studimesh të veçanta si p.sh.: Wilfried Fiedler 2004; Kristina Jorgaqi 2001; Mimoza Kore 2005; Joachim Matzinger 2006; Thoma Qendro 2014; Stefan Schumacher & Joachim Matzinger 2014 etj.

Gjithë këtij materiali leksikor të studiuar deri sot i janë bashkuar natyrshëm rezultatet e përftuara para dhe gjatë fazës së parë të projektit në fjalë, ku u është kushtuar rëndësi ndër të tjera edhe përpunimit filologjik sikurse realizimit të bashkëpërkimeve leksikore përkatëse për gjithë ato tekste të hershme shqip, që gjëllinin ndërkohë pa iu nënshtruar ende studimit të mirëfilltë filologjik, përkatësisht sosh që kërkonin domosdoshmërisht një rishikim kritik-redaksional, të mbështetur kryekëput në kriteret e sotme të punës filologjike me përmendoret e hershme të gjuhës shqipe, si p.sh.: Mandalà 1995, 2004a-b; Omari 2015; Demiraj 2006, 2008; 2012, 2017, 2019, 2020, 2021. E gjithë kjo punë paraprake ka mundësuar ndërkohë grumbullimin e materialit bazë që krijon kushtet për realizimin e korpusit të plotë digjital të leksikut historik të gjuhës shqipe.

¹ Shih bibliografinë në fund të punimit.

² Shih bibliografinë në fund të punimit.

2.3 Korpusi digjital i leksikut historik të shqipes

Me korpus digjital të leksikut historik të gjuhës shqipe kuptojmë produktin e përfutur prej digjitalizimit dhe përpunimit kompjuterik të gjithë pasurisë leksikore që trashëgojmë prej kulturës së hershme të shkrimit shqip¹. Bëhet fjalë për një fond prej rreth 100 tekstesh të shkurtra dhe të gjata, të cilat ruhen sipas rastit a) në dorëshkrim, si p.sh.: Da Lecce (1702); Da Desio (1710); Anonimi i Elbasanit (1761); *Kodiku Beratas* (shek. XVIII); *Codice Chieutino* (shek. XVIII); Vellaraj (1800) etj., b) si mbishkrime gravurash, si p.sh.: Gravura e Ardenicës (1731); dhe epitafesh (shek. XVIII – Roques 1932); d) si tekste të shkurtra shqip me një a më shumë fjali brenda tekstesh në gjuhë të huaj, si p.sh.: Formula e Pagëzimit (1462); *Formula e Mallkimit* (1483), *Fjalësi shqip i Ritter Arnold von Harff-it* (1497); *Letra e fretënve të Pultit* (1761) etj.; si edhe, madje sidomos e) si tekste kryesisht të gjata, të shtypura në shtypshkronja të kohës në qytete të ndryshme në Itali (Romë, Padova, Venedik). Ndonjë syresh madje ka parë dritën e botimit më shumë se një herë në hapësirën kohore në fjalë (khs.: Budi DC: 1618, 1636, 1664 – krahas 1868); ndërsa për një numër më të kufizuar botimesh disponojmë sipas rastit edhe dorëshkrimin origjinal përkatës dhe/ose kopje të tij (khs.: Matranga 1592; Radovani 1776), çka mundëson qëmtimin e ndërhyrjeve të mirëfillta redaksionale që janë përfutur para procesit të shtypit, sikurse edhe do shmangie të mundshme prej tekstit burimor që rezultojnë si lajthitje të realizuara shi gjatë procesit të shtypit prej stampuesve jonativë në shtypshkronjat në fjalë². Në procesin e përfutimit të korpusit gjuhësor digjital janë mbajtur parasysht edhe tipare të veçanta fonotaktike që shfaqin sidomos ato tekste të hedhura në letër prej autorësh jonativë, të cilët e zotëronin, sipas rastit, shumë mirë, mirë, pak e deri aspak shqipen e folur dhe atë të shkruar për periudhën në fjalë³.

¹ Përpunimi kompjuterik i të dhënave tekstuale – të realizuara dhe të njësuar në këndvështrimin redaksional prej Bardhyl Demirajt – së bashku me realizimin e bashkëpërkimeve leksikore është rezultat i angazhimit të dr. Besim Kabashit dhe të forcës shkencore Qëndresa Haliti si pjesëtarë të grupit të punës për realizimin e fjalorit në shqyrtim në fazën e tij të parë.

² Shih Mandalà 2004 93vv.; B. Demiraj 2017 511vv.

³ I tillë duket të ketë qenë p.sh. përkthyesi i akteve shqip të Kuvendit i Arbënit (1706), i cili – ndër të tjera – nuk dallonte në ndërgjegjen e vet gjuhësore zanoren qendrore të patheksuar /ë/. (Shih B. Demiraj 2012 51v.)

I gjithë ky vëllim material tekstual konsiderohet si pasuri e përbashkët në kulturën e hershme të shkrimit shqip e si e tillë është mbledhur e përpunuar, duke iu nënshtruar procesit të digjitalizimit kompjuterik, si fazë që i paraprin përpunimit, përkatësisht realizimit të bashkëpërkimeve leksikore për secilin tekst në veçanti.

3 Përpunimi filologjik dhe kompjuterik i leksikut historik të shqipes

Prurjet e derisotme të natyrës filologjike lidhur me përmendoret në fjalë kanë arritur në kohën tonë një pikë kulmore, aq sa lejohemi të mëtojmë me të drejtë se botimi kritik-ekdotik i trashëgimisë së kulturës së hershme të shkrimit shqip, ashtu siç e njohim sot për sot përbën ndërkohë një cikël thuajse të mbyllur. Është pikërisht kjo rrethanë që i përshtatet më së miri, madje tumir dukshëm edhe ndërmarrjen e projektit në fjalë, parë ky më fort si realizim i suksesshëm i së ashtuquajturës pjesë ase gjysmës së tij të parë, që vjen me thënë si fjalor “filologjik-historik digjital” i shqipes së hershme (shek. XV-XVIII). Theksojmë me këtë rast nocionet ‘përshtatje’, ‘tumirje’ deri edhe ‘nxitje’, të cilat shërbejnë si shtysa orientuese në punën e mirëfilltë me ‘përpunimin filologjik’ të leksikut historik të shqipes. Lejohemi t’i mëshojmë fort këtij qëndrimi, meqë në një vështrim të parë – të nxitur edhe nga programet e suksesshme bashkëkohore të teknikës kompjuterike (!!!) – dikush mund të krijojë një imazh të gabuar se përgjatë kësaj procedure mjafton thjesht dhe vetëm një skanim i kujdesshëm i botimeve ekdotike të derisotme, duke i konvertuar ato në dokumente digjitale të përpunimit të tekstit (me OCR si dokumente në Word), çka do të mundësonte lehtësisht më tej edhe përfundimin e bashkëpërkimeve leksikore si bazë të dhënash që sendërtojnë korpusin digjital të leksikut historik të shqipes. Përkundrazi, siç theksuam më sipër, kjo rrethanë fatlume është parë e diskutuar në projekt më fort si shtysë orientuese për vijimin e një pune të kualifikuar në përpunimin filologjik të leksikut historik të shqipes.

3.1 Leksiku historik në fokusin e filologjisë së tekstit (gjerm. *Textphilologie*)

Përpunimi filologjik e në vazhdimësi i leksikut historik mund të rrudhet në pamje të parë thjesht dhe vetëm në verifikimin,

përkatësisht në ndërhyrjet e nevojshme redaksionale lidhur me prurjet e derisotme në botimet kritike të përmendoreve të hershme në kulturën e shkrimit shqip, në të cilat sipas rastit, që vjen me thënë sipas formimit dhe synimeve të njërit apo tjetrit autor, u është mëshuar diku më shumë e diku më pak: botimit anastatik, transliterimit ase riprodhimit diplomatik, tejshkrimit (= transkriptimit) të zgjeruar deri edhe botimit të përkuqjesur të teksteve me një dozë sado të konsiderueshme arbitrariteti redaksional individual. Këtij variacioni në punën filologjike me tekstin i bashkohen sipas rastit si variacion po aq subjektiv botimet e ndryshme kritike të njërit apo tjetrit tekst, të cilat:

a) janë përfutur në distanca të ndryshme kohore dhe/ose prej më shumë se një dore, khs.:

- *Formula e mallkimit* (1482): L. Braun & M. Camaj 1972; J. Matzinger 2010; Demiraj 2012.

- *Perikope e Ungjillit / Tropari Pashkëve* (dsh. shqip në Bibl. Ambrosiana të Milanos): Lambros 1906; Borgia 1930; Belluscio 2012; Demiraj 2020.

- “*Meshari*” i Gjon Buzukut (1555): P. Schirò (dsh. – prej 1909); Resuli 1958; Çabej 1968; Hock 2003.

- “*E Mbsuame e Krështerë*” e Lekë Matrëngës (1492): Sciambra 1964; Sulejmani 1979; Mandalà 2004; Matzinger 2006.

- “*Cuneus Prophetarum...*” e Pjetër Bogdanit (1685): Mjeda 1930; Harapi 1940-43; Omari 2005, 2015.

- “*Codice Chieutino*” (shek. XVIII): Marchianò 1908; Schirò 1923; Mandalà 1995.

- “*Gjella e Shënmërisë Virgjër*” e Jul Varibobës (1762): Sh. Demiraj 2019; Fortino 1984; Belmonte 2002.

- *Glosari trigjuhësh i Anastas Kavalliotit* (1770): Qafëzezi 1934-43¹; Hetzer 1981.

¹ “Protopapa Theodhor Nastas Kavalioti Voskopojari, Shkollarku i Akademisë së Re të Voskopojës”, është një sintezë e 15 artikujve dhe studimeve të veçanta botuar nga autori gjatë periudhës 1934-1943 në revistat kulturore “Jeta”, “Minerva” etj. dhe që sot ruhen në dorëshkrim të daktilografuara në arkivin e Institutit të Historisë e Gjuhësisë në Tiranë.

• *Glosari katërgjuhësh i Mjeshtërit Dhanilit* (1802): Leake 1816; P. Papahagi 1909. Kristophson 1974; Lloshi: 2006; Demiraj (në shtyp: 2022).

• etj.

b) janë tejshkruar deri sot vetëm nga një dorë:

• *Veprat e Pjetër Budit* (DC 1618; RR dhe SC 1621) nga Svane 1985/86.

• *Fjalori në dorëshkrim i Francesco Maria Da Lecce-s* (1702) nga Gurga 2009.

• *Tekste në vargëzim dhe prozë të Niccolò Chetta-s* (shek. XVIII) nga Mandalà 2004.

• *Fjalori italisht-shqip i Niccolò Chetta-s* (1763) nga Cerniglia 2008.

• etj.

c) në mos janë ribotuar me përmirësime të rastit nga e njëjta dorë: “*Cuneus Prophetarum...*” i Pjetër Bogdanit (1685): Omari 2005 dhe 2015.

d) Për një shumësi tekstesh të gjata e të shkurtra që nuk kishin përjetuar ende studimin e mirëfilltë me aparatit shkencor-filologjik bashkëkohor, u ndërmorë paraprakisht përpunimi filologjik në tri faza: transliterim, tejshkrim, botim kritik i përkujdesur, ndër të tjera:

• *Doktrina e krishterë* e Gj.P.N. Kazazit (1743): Demiraj 2006.

• *Fjalori latinisht-shqip i Frang Bardhit* (1635): Demiraj 2008.

• *Aktet shqip të Kuvendit të Arbnit* (1706): Demiraj 2012.

• *Kodiku Beratas* (dsh. – shek. XVIII): Demiraj 2019.

• *Gravura e Ardenicës* (1731): Demiraj 2020.

• *Tekste të shkurtra të zbuluara dy dhjetëvjeçarët e fundit*: Demiraj 2017; Demiraj & Haug 2020; Çunga & Demiraj 2020.

e) Vështirësi shtesë që janë shfaqur për do botime të mëhershme, përkatësisht për do probleme që kanë dalë në një shumësi rastesh me shmangie të natyrës grafike-filologjike që ofrojnë sipas rastit autorë të ndryshëm, janë ndërmarrë studime në veçanti brenda kuadrit të projektit në fjalë¹.

Ky përshkrim sado i thukët i punës së derisotme filologjike me trashëgiminë në kulturën e hershme të shkrimit shqip shpresojmë të

¹ B. Demiraj 2017.

bëjë njëherësh më se të kuptueshme ndërhyrjen paraprake ndaj variacionit subjektiv-individual, me të cilin përballemi gjithkund gjatë leximit dhe përpunimit të materialit gjuhësor në kuadrin e filologjisë së tekstit, një variacion ky që kushtëzohet me disproporcionin në kohë të botimeve kritike, përkatësisht të aparatit shkencor-filologjik që zbaton njëri ose tjetri autor, deri edhe në kriteret metodike që parapëlqen secili syresh gjatë punës filologjike me njërin ose tjetrin tekst¹. Porë nga kjo perspektivë, përpunimi filologjik sipas një kriteri të përbashkët metodik për gjithë materialin gjuhësor që disponojmë prej trashëgimisë së kulturës së hershme të shkrimit shqip e bën më se të kuptueshme dhe të nevojshme atë punë paraprake që kemi realizuar gjatë përpunimit të gjithë kësaj trashëgimie në kuadrin e projektit në fjalë.

Shtojmë me këtë rast se gjatë përpunimit filologjik të materialit gjuhësor është realizuar edhe përqasja e botimeve të ndryshme për secilin tekst, duke u fokusuar gjithherë në zgjidhjet më të argumentuara që jep njëri apo tjetri studiues filolog. Pa dyshim që ky proces është përmbyllur gjithherë nëpërmjet ballafaqimit të botimit më të mirë ekdotik me tekstin burimor të shtypur ose në dorëshkrim, sa herë që është mundur kjo alternativë².

3.2 Leksiku historik në fokusin e filologjisë së fjalës (gjerm. *Wortphilologie*)

Pjesën specifike të përpunimit filologjik të leksikut historik shqipes si fazë e parë që i prin punës së mirëfilltë leksikografike-

¹ Përmendim këtu ndër të tjera shmangie në zgjidhje të natyrës filologjike-ekdotike prej filologësh të ndryshëm e botuesish teksteve, p.sh. sa i përket a) leximit dhe tejskrimit të grafemës <e> në pozicion të patheksuar përkatësisht me zanoren /e/ ose /ë/; b) leximit të <c> si /ç/ apo /c/; c) leximit të <i> si /i/ apo /j/; d) leximeve dyjare të grafemave <l> e <λ> si /l/ dhe/ose /ll/ etj.; e) lexime të gabuara nga autorë të ndryshëm me botimet kritike përkatëse, si p.sh.: /sasinjet/ për /safirjet/ te Buzuku (1555), gjë që ka çuar dhe në etimologjizim të gabuar; më tej: /bishër°/ për /biser°/ të grafisë <biferisc> te Kuvendi i Arbënit 1706; /streput/ për /strepui/ te da Lecce 1702; sikurse leximi /prestë/ për /presë/ i grafisë <preſſe> të Buzukut etj.; f) shmangie grafike nga shqiptimi i përgjithshëm prej autorësh jonativë të shqipes (da Lecce 1702, 1716; Kuvendi i Arbenit 1706; da Desio 1710 etj.) e shumë e shumë vështirësi të tjera në leximin e përpiktë.

² Sh. më lart shën. 12. Probleme të kësaj natyre, sidomos për do tekste arbërisht të shek. XVIII, sidomos sosh me autor Nicolò Chetta-n, ku mungonte ballafaqimi me burimet faksimile, kanë ndikuar në mosmbajtjen e tyre parasysh, përkatësisht mosrrokjen e tyre në inventarin e lemave në fjalor. (shih §4.1)

historike e paralelisht me të edhe asaj etimologjike në projektin në fjalë, e përbën hulumtimi i mirëfilltë i materialit tekstual në kuadrin e filologjisë së fjalës, gjë që u bën vend të konsiderueshëm analizave të mirëfillta të natyrës variacionale grafike, fonologjike, morfologjike, sintaksore dhe semantike për secilin tekst në veçanti. Gurët e sinorit që orientojnë përpunimin gjuhësor-filologjik të teksteve sigurisht që nuk mungojnë në historinë e punës filologjike me tekstet e vjetra shqip. Mjafton të përmendim me këtë rast punën ngulmuese e afatgjatë të filologut të njohur Kolë Ashta në opusin e tij me shtatë vëllime: “Leksiku historik i gjuhës shqipe”, sikurse disa ndër botimet kritike të realizuara prej studiuesve të njohur Armin Hetzer (1981) e Titos Jochalas (1985) e më tej sosh të filologëve të sotëm, si: Matteo Mandalà (1995; 2004; 2005), Gëzim Gurga (2009), Anila Omari (2015; 2016), Bardhyl Demiraj (2006...2022) etj. Prurje kësodore orientojnë edhe atë ndërmarrje ballore në projektin në fjalë, ku synohet në instancë të fundit mbledhja, krehja dhe klasifikimi qoftë i përbashkësive, ashtu edhe i variacionit dialektor deri stilistik-individual brenda korpusit të leksikut historik të shqipes. Kjo paketë syzimesh gjuhësore-historike dhe filologjike bëhet sa e prekshme aq edhe reale në bashkëlidhje me lematizimin e korpusit digjital të leksikut historik të shqipes, për të cilin le të ndalemi thukët në rubrikën që vijon:

4. Lematizimi i leksikut historik të gjuhës shqipe

Me lematizim të leksikut historik të shqipes nuk kuptojmë thjesht dhe vetëm një proces programimi kompjuterik për përpunimin gjuhësor-filologjik të të gjithë materialit tekstual në trashëgiminë e kulturës së hershme të shkrimit shqip. E kjo për një arsye fare të thjeshtë, thajse triviale: nuk janë zhvilluar e, pas gjase, as që pritet të zhvillohen dikur programe të tilla – assesi lukrative (!!!) – për gjuhë me korpus historike minore siç është rasti i trashëgimisë letrare në kulturën e hershme të shkrimit shqip në shekujt XV-XVIII. Për më tepër një programim të tillë e vështirëson tej mase variacioni leksikor-dialektor, sikurse edhe ai stilistik-individual që dallon dukshëm jo vetëm tekste dhe autorë të ndryshëm që kanë lëvruar shqipen larg njëri-tjetrit në kohë dhe hapësirë, por edhe, madje sidomos, variacioni gjuhësor-kronologjik në strukturat fonologjike e fjalëformuese,

sikurse, madje sidomos, variacioni tematik dhe trajtëformues brenda paradigmave të njësive leksiko-gramatikore të eptueshme, të cilat shfaqin shmangie të dukshme nga njëra zonë dialektore në tjetrën e nga njëri autor në tjetrin, duke rrokur këtu edhe syresh jonativë, përkatësisht sish me ndjesi të kufizuar, sa i përket zotërimit të sistemit fonetik dhe gramatikor të shqipes së folur në këtë hapësirë kohore.

Asgjëmangut, punën e mundimshme që shoqëroi në projekt lematizimin e leksikut historik të shqipes në një *database* të përbashkët, duke rrokur, klasifikuar dhe sistematizuar në të qoftë variacionin dialektor fonologjik ashtu edhe atë morfologjik e fjalëformues të ligjërimit bisedor, sikurse edhe atë të përkujdesur në trashëgiminë e kulturës së hershme të shkrimit shqip, e mbështeti dukshëm realizimi i bashkëpërkimeve leksiko-gramatikore (me veçoritë paradigmatiche përkatëse) për të gjithë materialin tekstual që disponojmë për periudhën në fjalë (Kabashi: shën. 8). Këtë proces e mundësoi paraprakisht përpunimi i mirëfilltë filologjik (§§ 3-3.2), që u përgatit në mënyrë të tillë që t'u përshtatej sa më mirë programeve kompjuterike përkatëse, të cilat arrijnë të përcjellin automatikisht në rend alfabetik të gjitha njësitë leksiko-gramatikore dhe fjalëformat e shpërndara gjithkund në fondin e digjitalizuar të shqipes së hershme.

4.1. Klasifikimi i lemave si zëra të veçantë në fjalor

Në procesin e lematizimit të korpusit digjital të shqipes së hershme janë mbajtur gjithherë parasysh baza teorike dhe aparati shkencor metodik i leksikografisë historike bashkëkohore, duke ia përshtatur atë realitetit gjuhësor që përcjell shqipja e vjetër si gjuhë e shkruar e me një korpus leksikor modest (gjerm. *Kleinkorpusssprache*). Prashtu inventarizimi i lemave në këtë fjalor të mirëfilltë filologjik-etimologjik është konceptuar – edhe pse me përjashtime të rastit (§4.3) – kryesisht si klasifikim në rend alfabetik i atij fondi leksiko-gramatikor që sendërton ‘fjalën leksikore’ si nocion përmbledhës për gjithë atë larmi njësish gjuhësore që mbulojnë sipas rastit bashkë ose veças koncepte të tilla të natyrës në dukje terminologjike si p.sh.: ‘pjesë ligjërare’ apo ‘njësi leksiko-gramatikore’, në mos sosh si ‘[fjalë] semantike’, ‘f. gramatikore’ pranë ‘f. morfologjike’ dhe ‘f. sintaksore’, sikurse ‘f. fonologjike’ përkatësisht ‘f. fonetike’ e më tej ‘f. grafike’ përkatësisht ‘f. grafematike’ etj. Parë nga kjo perspektivë në procesin

e lematizimit do të mund të ngërthenim si zëra të veçantë edhe do njësi gjuhësore që gjëlljnë në kufijtë e ‘fjalës’, ndër të tjera:

- Të ashtuquajturat ‘pjesëza’ gramatikore ose të pavetëmjaftueshme në rolin e formanteve njëfunksionale që janë përfutur falë prirjes drejt analitizmit në sistemin gjuhësor të protoshqipes dhe shqipes së hershme, si p.sh.: *do; të; u; duke, tuke, tue; le; pa* etj.. Këto na shfaqen si shënjes të ndryshëm kategorialë në dimensionet ‘kohë’, ‘mënyrë’, ‘diatezë’ etj.

- Leksikalizimi i fjalëformave të caktuara brenda marrëdhënieve paradigmatiche ekzistuese: *natën* f.nj.kall.shq. ~ *natën* ndf. ‘gjatë natës’; *dimrit* m.nj.rvj.shq. ~ *dimrit* ndf. ‘gjatë dimrit’ etj.

- Konversioni si derivacion i brendshëm automatik në varësi me funksionin sintaksor të njërive leksiko-gramatikore në mjedisin gjuhësor përkatës: *larë* pj./ndf. ~ *i larë* mb.nyj. ~ *të larë*, -t e.as.; *mirë* ndf. ~ *i mirë* mb.nyj. etj.

- Tipat e ndryshëm të fjalëformimit me të njëjtin funksion leksiko-semantik, që përgjithësisht ndërndërrojnë vendet nga një tekst në tjetrin apo nga njëri autor në tjetrin, duke shkuar kështu deri në kufijtë e izoglosave që përcaktojnë larminë dialektore në periudhën e hershme të lëvrimit të shqipes, khs. geg.vj. *beson* f. vs. tosk.vj. *besit* etj.

- Fjalëformime të çastit (gjerm. *Augenblickbildungen*), të veçuara e deri hibride që shfaqen te njëri ose tjetri autor, anipse në shumësinë e tyre nuk kanë përjetuar vijimësi në kulturën e mëvonshme të shkrimit shqip, khs: *lakëmueshim* (Chetta; da Lecce), *çminjueshim* ‘në mënyrë të turpshme’, *debëlueshim*, *denjshim* ‘degnamente = denjësisht’, *festueshim* ‘solemnisht’, *fortshim*, *studiueshim*, *me sfituem* ‘relaxare qualche cosa del suo = jap diçka nga fitimet e mia’ etj. (Da Lecce), *lëshueshim* ‘petulanter’, *banjitār* ‘balneator’, *çançatuer* ‘garrulus’ (Bardhi); *të pronunciuom* ‘shpallje’ (Budi); *të pādhimptunë* ‘crudeltà = mizori’, *të frym* ‘frymëzim = lat. *inspiratio*’ po edhe *të shpëryeshim* e *shpërim* ‘ispirazione’ me ndikime të ardhura nga burime të ndryshme, *të pāginë-të* ‘ingordigia = lakmi e madhe’, *e padroe-ja* ‘temeritas = guxim i tepruar’, *bajbukës* ‘paniere = që mban bukët’, *hanëplote* ‘plenilunio’, *letërisht* ‘fjalë për fjalë, sipas letrës’ etj. (Bogdani); *t’avitun* ‘avvicinamento’, *të stimuem* ‘conto’, krahas *stimë*; *të prodhuem* ‘giovamento’ (krahas *prodhë*) (Da Lecce); *me struquem* ‘palos më dysh’ (Da Lecce), etj. Fjalë librore (*mots savants*), të marra të gatshme prej

teksteve burimorë në gjuhë të huaj e duke ndërhyrë me ndonjë përshtatje të pjesshme sipas strukturave ekzistuese të leksikut të shqipes: *anatemë*, *apetit*, *maganjë* 'e metë', *makullë* 'njollë', *menacon* 'kërcënon', *manjifikon* 'madhështon', *maqe* 'njollë', *maravejë* 'çudi', *matutin* 'lutje e mëngjesit', *ornon* 'zbukuron', *oron* 'lutet', *patroçinie* 'mbrojtje' etj.etj. (Buzuku); *laudes*, -i 'një lutje fetare', *malicie* 'ligësi', *manipullë* 'pjesë e veshjes liturgjike', *matrimon* 'martesë', *obedient* 'i bindur', *suplikon* 'lut', *shinjifikon* 'do të thotë' etj. (Budi); *alfjer* 'flamurtar', *dicionār*, *dubiton* 'dyshon', *emendon* 'përmirëson', *error* 'gabim', *skrinjë* 'kuti', *me sprofunduem* 'zhytem' etj. (Bardhi); *akuilon*, *levant*, *maestër*, *ostro* 'emra të erërave', *avoj* 'fildish', *deçembre*, *novembre*, *setembre* 'emra të muajve', *izulë*, *kondënon*, *prinçipat*, *prishilianist*, *statere* etj. etj. (Bogdani); *bajok* 'lloj monedhe', *benefatuer* 'bamirës', *burraxhinë* 'borragine - lloj bari', *graton* 'grij djathin - it. grattare', *gulf* 'gji deti', *kason* 'prish me penë - it. cassare' etj. etj. (da Lecce); *ospiç* 'strehë', *parrok* 'prift i famullisë', *preshakrë* 'shumë i shenjtë', *subdiakonat* etj. (Kuvendi i Arbënit), *teologal* (Kazazi) etj.

- Emra të përveçëm të përfutur me material leksikor apelativ, khs.: *Benjeti* m.; *Bërnjeri* m.; *Dritprata* f.; *Dritrea* f. (Chetta ChT) etj,

- Hapax legomena, khs.: <*Dramburi*> të *kloft* o *goljë* (Formula e Mallkimit 1483); *Perëndilemë* f. 'nëna e Zotit' (Kodiku Beratas) etj.

Asgjëmangut, inventarizimi i lemave, që i parapriu si i tillë punës së mirëfilltë në hartimin e fjalorit të sipërpërmendur, u shoqërua paralelisht edhe me krehjen dhe seleksionimin e inventarit leksikor, parë ky proces si një ndërhyrje sa e vetëdijshme aq edhe sistematike në kuadrin e zhvillimit të projektit. Për më tepër, le të mbajmë parasysh që ky fjalor pritet të sendërtojë produktin e një projekti kërkimor të tipit afatshkurtër (maj 2018 – maj 2025), të cilin e mbulon me aktivitetin e vet shkencor-intelektual një staf tejet modest prej 5-6 studiuesish specialistë. Janë bash këto rrethana që bëjnë t'i anashkalohet çdo lloj doze utopizmi lidhur me realizimin e tij të patëmetë për një inventar potencial, që do të rrokte të gjitha njësitë gjuhësore me status të veçantë leksiko-gramatikor që shfaqen në kulturën e hershme të shkrimit shqip. Në këndvështrim perspektiv kjo rrudhje e vetëdijshme e inventarit faktik shkon gjithsesi në proporcion të drejtë me rritjen e cilësisë së produktit shkencor në

kuadrin e këtij projekti e që në një mënyrë a një tjetër lë hullinë hapur për përsosmëri edhe plotësi në të ardhmen.

Sistematika në seleksionimin e inventarit të lemave në fjalor konsiston në kriteret e mënjanimit konsekuent të disa grupeve leksiko-gramatikore, si vijon:

- Fjalëterma specifike që shfaqen me shumicë sidomos në përkthime të teksteve me natyrë teologjike, liturgjike ose sosh të së drejtës kanonike kishtarë, të cilat janë marrë të gatshme prej teksteve burimorë në gjuhë të huaj nga njëri ose tjetri autor, duke ia përshtatur si të tilla rregullave të leximit të shqipes. Në këtë grup rroken edhe përshtatjet sipas strukturës tingullore dhe tematike të shqipes për një numër zërash leksikore në fjalorë dhe glosarë dygjuhësh, sidomos sosh të leksikut abstrakt, ku autorët në pamundësi të njohjes përkatësisht të mungesës së gjegjëseve leksikore anase në shqipe, janë mjaftuar me huazimin individual prej tekstit burimor në gjuhë të huaj.

- Orientalizma të skajshëm e pa vazhdimësi në fazat e mëvonshme të kulturës së shkrimit shqip, të cilat shfaqen me shumicë në poezinë e bejtexhinjve, madje edhe aty sidomos në vargëzimin e përzier osmanisht-turqisht-shqip.

- Fjalëkrijime individuale, të përftuara sidomos gjatë përkthimit të teksteve të natyrës teologjike-liturgjike ose në fjalorë dygjuhësh, të cilat u shmangen gjedheve fjalëformuese në gramatikën produktive të shqipes së vjetër. Në po këtë grup janë ngërthyer edhe një numër i madh fjalëkrijimesh mikse që dëshmojnë përzierje të vetëdijshme tiparesh dialektore në strukturën tingullore të temave përkatëse.

- Një numër i konsiderueshëm arbëreshizmash me përhapje tejte të kufizuar rajonale e që shfaqen vetëm te një autor – që vjen me thënë nuk përjetojnë vijimësi në kulturën e shkrimit shqip-arbërisht –, janë mënjanuar qoftë edhe përkohësisht prej inventarit, meqë duhet t'u nënshtrohen një metodike specifike studimi në bashkëvajtje me mjedisin dialektor italisht përkatës.

4.2. Përzgjedhja e fjalëformave gramatikore gjatë lematizimit

Përpunimi kompjuterik i gjithë materialit gjuhësor të përftuar në fazën e hershme të lëvrimit të shqipes, përkatësisht realizimi i bashkëpërkimeve leksikore për çdo tekst në veçanti, lehtëson potencialisht punën edhe për mbledhjen, sistematizimin dhe

klasifikimin e fjalëformave në paradigmata ekzistuese për njësitë leksiko-gramatikore të eptueshme brenda fondit leksikor të shqipes së vjetër. Ndërmarrja ballore e një pune të tillë është sigurisht e mirëseardhur në një projekt të veçantë lidhur me përpunimin intensiv kompjuterik dhe përfitim të korpusit digjital të shqipes së vjetër, veçse në projektin në fjalë kjo do t'i shmangej natyrshëm qoftë konceptimit, ashtu edhe kriterëve metodike dhe punës konkrete për realizimin e një fjalori digjital filologjik të shqipes së vjetër. Gjithsesi, duke qenë se aspekti filologjik i leksikut historik të gjuhës shqipe mbulon një rën pjesë kryesore të këtij projekti, është operuar në mënyrë selektive me mbledhjen, sistematizimin dhe klasifikimin tabelar të një numri fjalëformash që paraqesin interes të veçantë sidomos në studimet historike-krahasuese e që potencialisht ndihmojnë edhe në rindërtimin e brendshëm të fazave të mëhershme gjuhësore të protoshqipes. Si kriterë metodike në përzgjedhjen e fjalëformave gramatikore dallojmë, ndër të tjera:

- Përshtetja e hollësishme tabelar gëzojnë kryesisht apelativat e thjeshtë, përkatësisht syresh me një strukturë të tillë morfologjike, që nuk zbërthehet më tej në ndërgjegjen (e sotme) gjuhësore.

- Lidhur me pjesët e eptueshme të ligjëratës, interesimi fokusohet kryesisht në marrëdhëniet paradigmatiche që dëshmojnë emrat, përemrat dhe foljet e thjeshta, sikurse edhe do mbiemra të parregullt, përkatësisht syresh që shfaqin marrëdhënie paradigmatiche aberrante në numrin shumë.

- Paraqitja e marrëdhënieve paradigmatiche kufizohet përgjithësisht në mbledhjen, sistematizimin dhe klasifikimin e fjalëformave gramatikore sintetike.

- Së fundi, kjo procedurë realizohet me akribi të veçantë sidomos në ato njësi që dëshmojnë shumësi dhe larmi fjalëformash sintetike të shpërndara nëpër tekste autorësh të ndryshëm e që plotësojnë deri diku edhe peizazhin kulturor-dialektor të shqipes së vjetër.

Zbatimi me konsekuencë i këtyre kriterëve metodike gjatë lematizimit të fondit leksikor të shqipes së vjetër mbështet dhe ndërlidh natyrshëm këtë punë paraprake të lematizimit me pjesën e dytë kryesore të punës (Moduli II – Hackstein), që ngërthen përpunimin etimologjik të të dhënave që përcjell shqipja e vjetër si

gjuhë sa indoeuropiane aq edhe europiane dhe ballkanike në periudhën ndërmjet shek. XV - XVIII.

4.3 Inventari i lemave në fjalor

Mënjanimi sistematik i njësive leksiko-gramatikore, që u takojnë grupimeve të sipërpërmendura (§§4-4.1), mundëson përfundimin e një inventari leksikor që paraprakisht rrok 3.719 zëra fjalësh të parme në fjalor, përkatësisht sosh që në ndërgjegjen e sotme gjuhësore nuk zbërthehen më tej në strukturën e tyre tematike-fjalëformuese. Përndryshe inventari i plotë së bashku me fjalët jo të parme që do të përpunohen në fjalor arrin shifrën e përafërt të 14.800 njësive leksiko-gramatikore.

4.4 Spektri leksikor-semantik i lemave në veçanti

Proporcione të ngjashme synojmë të përcjellim në projekt edhe nëpërmjet fiksimit të spektrit leksikor-semantik të lemave në veçanti. Parë nga kjo perspektivë, përpunimi filologjik së bashku me digjitalizimin e të gjithë trashëgimisë gjuhësore në kulturën e hershme të shkrimit shqip lejon analiza të përpikta leksiko-gramatikore që përcjellin natyrshëm për çdo rast spektrin kuptimor dhe radiusin semantik të lemave qoftë në veçanti si të tilla ashtu edhe në bashkëlidhje me mjedisin gjuhësor dhe realitet historike-kulturore, ku shfaqen e që mundësojnë përdorimin e tyre. Prashtu krahas përcaktimit të kuptimeve, përkatësisht të përbërësve themelorë të kuptimit, është vënë në dukje brenda mundësive edhe përdorimi i secilës lemë në veçanti në kulturën materiale dhe/ose shpirtërore të folësve nativë, sikurse edhe mjedisi gjuhësor që përcjell në një mënyrë a një tjetër fushat kuptimore të fjalës, deri edhe përdorimi i specializuar i saj si fjalë-term në fusha të ndryshme të marrëdhënieve shoqërore e materiale. Përfaqja e çdo përdorimi të fjalëve në sfondin tekstual përkatës lejon edhe një farë hierarkizimi brenda spektrit leksikor semantik, ku sistematizohen sipas rastit kuptimi themelor dhe zgjerimet e tij nëpërmjet përdorimit metaforik ase eufemistik, të atij metonimik e deri në veçoritë stilistike që shfaq gjuha e njërit apo tjetrit autor. Ky përshkrim në dukje statik i spektrit leksikor-semantik për çdo lemë në veçanti vendos natyrshëm sinorët që ka përshkuar historia e fjalës, përkatësisht dinamika e zhvillimit të kuptimit të saj

në kohë dhe hapësirë e duke mundësuar si e tillë edhe ndërhyrje të sigurta në studimin historik-krahasimtar dhe etimologjik të fjalës.

5. Struktura e lemave në fjalor (pjesa filologjike-historike)

Në mbyllje të këtij përshkrimi informativ të projektit le të ndalemi thukët edhe në strukturën që është konceptuar për paraqitjen e lemave në fjalor. Përshkrimi i çdo leme në fjalor rrok sipas rastit deri dhjetë rubrika:

- I. {koka e lemës}
- II. {dëshmia më e hershme}
- III. {përhapja kulturore-gjeografike}
- IV. {marrëdhëniet paradigmatiche dhe variacioni tematik}
- V. {kuptimi}
- VI. {rindërtimi i protoformës indoeuropiane}
- VII. {rindërtimi i brendshëm i bazës protoshqipe / fjalëformimi}
- VIII. {fjalëformimi brendagjuhësor / burimi i huaj}
- IX. {materiali krahasues në kontekstin protoindoeuropian dhe fiksimi i formës bazë}
- X. {bibliografia}
- XI. {referencat leksikore}
- XII. {sigla e autorit: alternative}

Ndër rubrikat e rreshtuara më lart, e para lidhet pandërmjetshëm me regjistrimin e lemës sipas rendit alfabetik, duke mbajtur parasysh këtu normën ortografike të leksikut të shqipes standarde e duke rrokur aty edhe të dhënat kryesore gramatikore dhe kuptimore¹. Kjo formë përfaqësuese e fjalës, e fiksuar si koka e lemës (= e zërit leksikor) i referohet zakonisht variacionit dialektor që shoqëron përdorimin e fjalës në kulturën e hershme të shkrimit shqip gjithkund në hapësirën shqipfolëse. Aso rasash, kur fjala nuk ekziston në leksikun normativ, rindërtohet *ad hoc* një formë përfaqësuese – e paraprirë me një asterisk (*) – që i përshtatet *pro forma* normës leksikore bashkëkohore. Kjo ndërhyrje bëhet për hir të sistematikës në inventarizimin e lemave.

Katër rubrikat në vazhdim (II-V) ngërthejnë në vetvete pjesën e parë të projektit, shi atë historike-filologjike që synon të përcjellë me saktësi përpos dëshmisë së parë të fjalës (II) edhe përhapjen dhe

¹ Ndryshe nga praktika leksikografike në hapësirën shqipfolëse, për kokën e lemave foljore është parashikuar si fjalëformë përfaqësuese jo veta e parë, por veta e tretë njëjës.

përdorimin e saj në aksin kronologjik (shek. XV-XVIII) tek autorë të ndryshëm, që u takojnë tri arealeve kulturore-gjuhësore (III) të përmendur më lart. Në këto dy rubrika fjala regjistrohet zakonisht brenda kontekstit gjuhësor ku shfaqet. Rubrika ndjekëse (IV) përcjell në plotësinë e saj variacionin individual dhe dialektor që shoqëron sipas rastit qoftë strukturën tingullore të temës së fjalës, ashtu edhe atë trajtëformuese brenda paradigmave përkatëse. Ky variacion, i grupuar sipas arealeve dialektorë dhe kulturorë-gjeografikë, shoqërohet hollësisht në mënyrë tabelare sidomos për fjalët e thjeshta që funksionojnë si pjesë të eptueshme të ligjëratës. Rubrika V paraqet në mënyrë sistematike spektrin kuptimor me radiusin semantik dhe/ose përdorimin sintaksor për secilën njësi leksiko-gramatikore në veçanti e gjithherë në kontekstin gjuhësor-filologjik përkatës. Vëmendje e veçantë u kushtohet gjithashtu regjistrimit të sintagmave të qëndrueshme si edhe të shprehjeve frazeologjike që shfaqen te më shumë se një autor, anipse kjo kërkesë për arsye të vëllimit të madh të materialit gjuhësor faktik nuk është ndjekur gjithherë e për çdo njësi leksiko-gramatikore në mënyrë konsekuente.

Kjo paraqitje, në dukje statike, e variacionit formal dhe leksiko-semantik në dimensionet kohë dhe hapësirë (rubrikat II-V) mundëson sigurinë e nevojshme për ndërmarrjen e hapave të fundit (rubrikat VII-VIII) që sendërtojnë jetën dhe historinë e fjalës (*étymologie - histoire des mots*) kryesisht gjatë fazës së parë të shkrimit shqip. Bëjmë fjalë këtu për induktime dhe deduktime të sigurt, sa i përket rindërtimit të bazës së përbashkët paradialektore (= protoshqipe: deri në shek. VI-VIII e.j.), sikurse edhe dinamikës së zhvillimit të brendshëm të kuptimit që ka përjetuar çdo fjalë qoftë si e tillë në veçanti, qoftë si pjesë përbërëse e leksikut të shqipes së shkruar në shek. XV-XVIII. Kjo rubrikë është sigurisht e pranishme edhe në paraqitjen e fjalëve jo të thjeshta, veçse këso rasash përmbushet si kërkesë e dorës së parë motivacioni i fjalëformimit të lemës, përftimi i saj me mjetet e fjalëformimit produktiv ose arkaik të shqipes për periudhën në fjalë, duke dhënë në fund referencat përkatëse për atë lemë, që ka shërbyer si bazë fjalëformuese për lemën në fjalë, përkatësisht për çerdhen leksikore ekzistuese në gjuhë (rubrika X).

Rimarrja e qerthullit problemor që përcjell rindërtimi i brendshëm i bazës semantike-morfemore që qëndron në themel të

fjalëformimeve largvajtëse, së bashku me veçoritë që karakterizojnë strukturën e saj fonologjike nxisin ndërmarrjen paraprake në fiksimin e burimit të fjalës (rubrika VIII), i cili në varësi të këtyre karakteristikave i krijon hapësirën e nevojshme opsionit të huazimit në gjuhë, bash sipas kategorizimeve përkatëse, si: huazime, fjalë të huaja, fjalë diturake (*mots savants*), kalke leksikore-semantike, sajesa dhe fjalëformime individuale të çastit etj.

Rubrikat VI dhe IX përditësojnë lexuesin me rezultatet dhe argumentin gjuhësor që përcjell studimi i thelluar etimologjik për nga perspektiva e gjuhësisë historike-krahasimtare dhe indoeuropiane (*Étymologie d'origine: Moduli II – Hackstein*).

Rubrika përmbyllëse (X) përcjell në mënyrë kompakte dhe selektive studiues e studime që janë marrë konkretisht me hulumtimin etimologjik të lemave përkatëse, sidomos të atyre që janë fjalë të thjeshta.

5. Përfundim

Përfundojmë këtu kumtesën tonë me shpresë që arritëm të shtjellojmë sado thukët atë temë që sinjalizuam qysh në titull, si: “Leksiku historik i gjuhës shqipe (shek. XV-XVIII) në fokusin e përpunimit filologjik-etimologjik bashkëkohor”, i cili i përcjell auditorit natyrshëm nismën dhe synimet kryesore të projektit “Fjalor digital filologjik-etimologjik i shqipes së vjetër (shek. XV-XVIII)” që drejtojnë qendrat universitare shkencore-universitare në albanologji (Prof. dr. Bardhyl Demiraj) dhe në indoeuropianistikë (Prof. dr. Olav Hackstein). Bëhet fjalë për një fjalor të një tipi të ri historik-filologjik dhe etimologjik si në albanologjinë historike, ashtu edhe në indoeuropianistikë, e që plotëson si i tillë nevojat kryesore të studimit diakronik dhe sinkronik të shqipes së hershme, duke krijuar njëherësh një fundament të sigurt shkencor-metodik në zgjerimin e mëtejshëm të punës filologjike e etimologjike me fazat e mëvonshme të lëvrimit të shqipes (shek. XIX-XXI) e duke i integruar ato në njohjen dhe studimin e thelluar të leksikut dialektologjik dhe atij bashkëkohor në hapësirën kompakte shqipfolëse dhe në diasporën historike shqiptare.

Rezultatet paraprake në hetimin e disa lemave shoqërojnë si shtojcë këtë kumtesë, ndërkohë që gjithkush mund të ketë qasje në arritjet e projektit në fazën e parë të punës së tij në faqen:

<https://www.dpwa.gwi.uni-muenchen.de/dictionary/>, ku janë zbardhur rreth 1200 zëra.

6. Literaturë shkencore-filologjike e cituar

Abazi-Egro, Genciana (ed.): *Hasan Zyko Kamberi: Poezi*. QSA IGJL. Tiranë, 2016.

Altimari, Francesco: *Features of the Albanian dialect of Istria in the manuscripts of Pietro Stancovich (1771-1851)*. Në: "Shêjzat – le pleiadi" (series nova), nr. 1-2, 2020, f. 147-178.

Ashta, Kolë: *Leksiku historik i gjuhës shqipe*, bl. I (Shkodër 1996); bl. II (Tiranë 1998); bl. III (Shkodër 2000); bl. IV (Shkodër 2002); bl. V (Shkodër 2009); bl. VI (Shkodër 2012); bl. VII (Shkodër 2017).

Belmonte, Vincenzo (ed.): *Jul Variboba, Gjella e Shën Mëris Virgjër* (Introduzione di Anton N. Berisha; trascrizione di Vincenzo Belmonte). Prishtinë, 2002.

Belluscio, Gianni: *Il manoscritto fol. 63 del Codice B 112 SUP OLIM T 360 della Biblioteca Ambrosiana di Milano. Una Cronistoria*. Në: 'Studime për nder të Rexhep Ismajlit me rastin e 65 vjetorit të lindjes' (Bardh Rugova – ed.). Prishtinë, 2012, f. 55-90.

Borgia, Nilo: *Pericope evangelica in lingua albanese del sec. XIV*, Grottaferrata, 1930

Braun, L. & Camaj, M.: *Ein albanischer Satz aus dem Jahre 1483*. Në: *Zeitschrift für vergleichende Sprachforschung* nr. 86, 1972/1.

Camaj, Martin: *Il "Messale" di Gjon Buzuku*. Roma, 1960.

Cerniglia, Giuseppina: *Nicolò Chetta: Leksiko liti, kthiellë arbërisht (1763)*. In: "Albanica" – *Collana di albanistica fondata da Antonino Guzzetta, diretta da Matteo Mandalà*, nr. 28. *Unione dei comuni "Besa"*. Palermo, 2008.

Çabej, Eqrem (ed.): "Meshari" i Gjon Buzukut (1955). *Botim kritik. Punuar nga Eqrem Çabej, Pjesa I: Hyrje dhe transliterim; Pjesa II: Faksimile dhe transkribim fonetik*. Tiranë, 1968

Demiraj, Bardhyl (ed.): *Gjon P. Nikollë Kazazi dhe 'Doktrina' e tij*. ASHAK, Prishtinë, 2006.

Demiraj, Bardhyl (ed.): *Dictionarium latino-epiroticum per R. D. Franciscum Blanchum, (Romae 1635)*. *Botim kritik dhe konkordanca leksikore*. Shkodër 2008.

Demiraj, Bardhyl (ed.): *Concili Provintiaali o Cuvendi j Arbenit (Romæ 1706)*. *Botim kritik*. Botime Françeskane, Shkodër, 2012.

Demiraj, Bardhyl: *Areali kulturor i Veriut në shek. XVI-XVIII*. Onufri, Tiranë, 2017.

Demiraj, Bardhyl (ed.): *Kodiku beratas*. ASHSH, Tiranë, 2019.

Demiraj, Bardhyl: *Die albanischen und aromunischen Inschriften der Gravur von Ardenica. Neubearbeitete und ergänzte Publikation mit Archivmaterialien von AQSH*. Në: "Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikografie und der Philologie der Gegenwart. Akten der 6. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung (27. shtator 2019, Buçimas – Pogradec)" (Demiraj, B. – ed.). Në serinë: "Albanische Forschungen" AF Bd. 44 (Bartl, P. & al. – ed.). Wiesbaden 2020, f. 315-346.

Demiraj, Bardhyl & Çunga, Sokol: *Ein albanisches Manuskript im Handschriftenbestand der Klosterbibliothek der Heiligen Trinität auf der Insel Chalki*. Në: "Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart. Akten der 6. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung (27. shtator 2019, Buçimas – Pogradec)" (Demiraj, B. – ed.). Në serinë: "Albanische Forschungen" AF Bd. 44 (Bartl, P. & al. – ed.). Wiesbaden 2020, f. 239-268.

Demiraj, Bardhyl & Haug, Judith I.: *Ein frühes Zeugnis altalbanischer Schriftkultur und Musik: Das Kompendium des 'Alī Ufukī (nach ca. 1635)*. Në: "Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart. Akten der 6. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung (27. Shtator 2019, Buçimas – Pogradec)" (Demiraj, B. – ed.). Në serinë: "Albanische Forschungen" Bd. 44 (Bartl, P. & al. – ed.), Wiesbaden 2020, f. 220-238.

Demiraj, Bardhyl: *Dorëshkrimi shqip në Veneranda Biblioteca Ambrosiana të Milanos (B 112, sup; fol 63^{r/v})*. Në: "Studime" 26 [2019] 43-103. Prishtinë 2020.

Demiraj, Bardhyl: *Kodiku i Kostë Cepit – Vithkuqarit (1822-1823). Vendi i tij në trashëgiminë e kulturës së shkrimit shqip me alfabet grek*. Në: "Hylli i Dritës" 1 [2021] 150-188. Shkodër.

Demiraj, Bardhyl: *Materiali shqip në veprën e Mjeshtër Dhanilit Εισαγωγική Διδασκαλία (1802) (18 S. – in print)*

Demiraj, Shaban (postum): *Jul Variboba në trashëgiminë e tij*. (Demiraj, B. – ed.) ASHSH. Tiranë, 2019.

Dibra, Fatos: *The Albanian Lexicon of Evliya Çelebi's Seyahatname in the Context of Old Albanian*. Në: "Altalbanische Schriftkultur – aus der Perspektive der historischen Lexikographie und der Philologie der Gegenwart. Akten der 6. Deutsch-Albanischen Kulturwissenschaftlichen Tagung (27. September 2019, Buçimas bei Pogradec, Albanien)" (Demiraj, B. – ed.). Në: (Bartl, P. & al. – ed.) "Albanische Forschungen", bl. 44. Wiesbaden, 2020, f. 269-314.

Elsie, Robert: *The Albanian Lexicon of Arnold von Harff. 1497*. Në: "Historische Sprachforschung" 97, 1984, f. 113-122.

Fiedler, Wilfried: *Das albanische Verbalssystem in der Sprache des Gjon Buzuku (1555)*. ASHAK. Prishtinë, 2004.

Fortino, Italo Costante: *Giulio Variboba, La vita di Maria. Prolegomeni, trascrizione, traduzione, glossario e note di Italo Costante Fortino*. Cosenza, 1984.

Gurga, Gëzim (ed.): *At Francesco Maria da Lecce O.F.M.: Dittionario Italiano-Albanese (1702). Botim kritik me hyrje dhe fjalësin shqip*. Botime Françeskane. Shkodër, 2009.

Harapi, Mark (ed.): *Emzot Pjeter Bogdani 'Cuneus Prophetarum' a se Çeta e Profetve, qitë n'alfabetin e soçëm e kthiellue me vrojtime prej M. H., Pjesa I. Në: "Lajmtari i Zëmrës së Krishtit"*. Shkodër, 1940-1943.

Hetzer, Armin: *Der sogenannte Kodex von Berat. Teil I. Në: "Balkan Archiv" (neue Folge) 6, 1981, f. 125-197.*

Hock, Wolfgang (ed.): *Buzuku "Missale". On the basis of the facsimile editions by Namik Ressuli, Il "Messale" di Giovanni Buzuku, Città del Vaticano: Biblioteca Apostolica Vaticana, 1958 and Eqrem Çabej, Meshari i Gjon Buzukut (1555), I-II, Prishtinë: Rilindja 1987 entered by Wolfgang Hock, Berlin 2000-2002; TITUS version by Jost Gippert, Frankfurt a/M, 9.3.2003: (<http://titus.uni-frankfurt.de/texte/etcs/alban/buzuku/buzuk.htm>).*

Jochalas, Titos: */Stoicheia hellêno-albanikês grammatikês kai hellêno-albanikoi dialogoi. Anekдото ergo tu iôannê Bêlara, Filologikê ekdosê apo ton autografo kôdika tês Ethnikês Bibliothêkês tôn Parisiôn/. Thessalonika 1985.*

Jorgaqi, Kristina: *Ndikimi i italishtes në letërsinë e vjetër shqipe*. Toena, Tiranë, 2001.

Kore, Mimoza: *Parafjalët në "Mesharin" e Gjon Buzukut*. Tiranë, 2005.

Kristophson, Jürgen: *Das Lexikon Tetraglosson des Daniil Moschopolitis. Në: "Zeitschrift für Balkanologie" Bd. 10, 1974 (stud. të veçanta), f. 7-128.*

Lambros, Spyridon / Λάμπρος Σπυρίδων: *Το Χριστός Ἀνέστη ἀλβανιστί. Το εὐαγγέλιον της μεγάλης Παρασκευής ἀλβανιστί. Në: "Νέος Ἑλληνομνήμων" III, τχ. 3-4, 1906. Ἀθήναι, 481-482.*

Leake, W. Martin: *Researches in Greece*. London, 1814.

Lloshi, Xhevat (ed.): *W. Martin-Leake, Kërkime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, në librin "Researches in Greece", Londër 1814 (përkthyer dhe paraqitur nga prof.dr. Xhevat Lloshi)*. Bota Shqiptare, Tiranë, 2006.

Malaj, Vinçenc (ed.): *Kuvendi i Arbënit 1703, Prishtinë 1998.*

Mandalà, Matteo (ed.): *Nicolò Figlia: Il Codice Chieutino (a cura di Matteo Mandalà)*, Istituto di Lingua e Letteratura Albanese. Facoltà di Lettere e Filosofia, Comune di Mezzoiuso, Palermo, 1995.

Mandalà, Matteo (ed.): *Luca Matranga: E mbsuame e krështerë (a cura di Matteo Mandalà)*. Në: "Albanica". Collana di albanistica fondata da Antonino Guzzetta, diretta da Matteo Mandalà, nr. 21. Caltanissetta, 2004.

Mandalà, Matteo (ed.): *Nicolò Chetta: Testi letterari in albanese (Edizione critica a cura di Matteo Mandalà)*. Në: "Albanica" – Collana di albanistica

fondata da Antonino Guzzetta, diretta da Matteo Mandalà, nr. 22. Caltanissetta, 2004.

Mandalà, Matteo: *Profilo storico-antologico della letteratura degli Albanesi di Sicilia*, vol. I. Në: "Albanica" – Collana di albanistica fondata da Antonino Guzzetta, diretta da Matteo Mandalà, nr. 23. Caltanissetta 2005.

Matzinger, Joachim: *Der altalbanische Text [E] Mbsuame e Krështerë (Dottrina Cristiana) des Lekë Matrënga von 1592. Eine Einführung in die albanische Sprachwissenschaft*. Në: Jenaer Indogermanistische Textbearbeitung, Bd. 3. Dettelbach, 2006.

Matzinger, Joachim: *Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 1: Ein Überblick zur vorliterarischen Dokumentation*. In: (Monica Genesin & al. – ed.) "The Living Skanderbeg. The Albanian Hero between Myth and History". Hamburg, 2010, f. 41-69.

Matzinger, Joachim, *Die albanische Sprache im Zeitalter Skanderbegs, Teil 2: Verschriftung des Albanischen mit Schwerpunkt auf Paulus Angelus und Gjon Buzuku*. Në: (B. Demiraj – ed.) *Wir sind die Deinen. Studien zur albanischen Sprache, Literatur und Kulturgeschichte, dem Gedenken an Martin Camaj (1925-1992) gewidmet*. Në serinë: "Albanische Forschungen" 29. Wiesbaden, 2010, f. 421-486.

Mjeda, Ndre: *Jeta e së lumes Virgjin Mrí, nxjerrun prej veperës "Cuneus Prophetarum" së Simzot Pjetër Bogdanit Argjipeshkvit së Shkupsë, përshkrue e botue prej D. Ndre Mjedsë*. Shkodër, 1930.

Omari, Anila (ed.): *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve)*. Botim kritik. ASHSH, Tiranë 2005.

Omari, Anila (ed.): *Pjetër Bogdani. Cuneus Prophetarum (Çeta e Profetëve)*. Botim kritik i përmirësuar. Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë 2015.

Omari, Anila: *Leksiku i veprës së Pjetër Bogdanit*. QSA, Tiranë, 2016.

Papahagi, Pericle: *Scriitori aromâni în secolul al XVIII: Cavalioti, Ucuta, Daniil*. Inst. de Arte Grafice "Carol Göbl", București, 1909.

Qafëzezi, Ilo Mitkë: *Protopapa Theodhor Nastas Kavalioti Voskopojari, Shkollarku i Akademisë së Re të Voskopojës 1934-1943* (Sintezë e 15 artikujve dhe studimeve të veçanta botuar nga autori gjatë periudhës 1934-1943 në revistat kulturore "Jeta", "Minerva" etj. dhe që sot ruhen në dorëshkrim të daktilografuara në arkivin e Institutit të Historisë e Gjuhësisë në Tiranë.)

Qendro, Thoma: *Fjalor i shqipes së Gjon Buzikut (me rreth 3200 fjalë, 350 emra të përveçëm dhe 260 fjalë e shprehje latinisht)*. Tiranë, 2014.

Resuli, Namik (ed.): *Il "Messale" di Giovanni Buzuku. Riproduzione e trascrizione*. Città del Vaticano, 1958.

Roques, Mario: *Recherches sur les anciens textes albanais*. Paris 1932.

Rrota, Justin: *Monumenti më i vjetri i Gjuhës Shqype. D. Gjon Buzuku (1555)*. Në: "Hylli i Dritës" VI (1930), nr. 1, f. 33-53. Shkodër.

Rrota, Justin: *Prej librit të Buzukut (1555)*. Në “Hylli I Dritës” VI (1930), nr. 2, f. 108-114; VI (1930), nr. 4, f. 231-238; VI (1930), nr. 5, f. 292-300; VI (1930), nr. 10, f. 569-576; VI (1930), nr. 12, f. 671-680. Shkodër.

Rrota, Justin: *Shkrimtari më i vjetri i Italo-Shqyptarvet, Lukë Matranga (1592)*. Në: “Hylli i Dritës” VII (1931), nr. 8, f. 505-522.

Schumacher, Stefan & Matzinger, Joachim: *Die Verben des Altalbanischen: Belegworterbuch, Vorgeschichte Und Etymologie*. Në serinë: “Albanische Forschungen” Bd. 33 (Bartl, P. & al. – ed.). Harrassowitz, Wiesbaden, 2014.

Sciambra, Matteo: *La “Dottrina cristiana” albanese di Luca Matranga. Riproduzione, trascrizione e commento del Codice Barberini Latino 3454*. Città del Vaticano, 1964.

Sulejmani, Fadil: *E mbsuame e krështerë e Lekë Matrëngës*, Prishtinë, 1979.

Svane, Gunnar: *Pjetër Budi. Dottrina christiana (1618). With a transcription into modern orthography and a concordance (= Sprog og Mennsker 9)*. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet. Århus 1985.

Svane, Gunnar: *Pjetër Budi. Rituale Romanum (1621). With a transcription into modern orthography and a concordance (= Sprog og Mennsker 13)*. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet. Århus 1986.

Svane, Gunnar: *Pjetër Budi. Speculum Confessionis (1621). With a transcription into modern orthography and a concordance (= Sprog og Mennsker 11)*. Institut for Lingvistik, Aarhus Universitet. Århus, 1986.

de Vaan, Michiel: *Franciscus Blanchus. Dictionarium Latino-Epiroticum. On the basis of the original edition Dictionarium Latino Epiroticum, per R.D. Franciscum Blanchum. Romae: Typis Sac.Congr.de Propag. Fide. 1635 entered by Michiel de Vaan. Leiden 2004. Në: TITUS version by Jost Gippert. Frankfurt a/M, 30.4.2006 / 17.1.2010:*
<<http://titus.uni-frankfurt.de/texte/etcs/alban/blanchus/blanc.htm>>

von Windisch, Karl Gottlieb: *Von den Klementinern in Syrmien*. Në: “Ungrisches Magazin oder Beyträge zu ungrischen Geschichte, Geographie, Naturwissenschaft und der dahin einschlagenden Litteratur”. Pressburg (Bratislava), 2 (1) 1782, f. 77-89.

7. Shtojcë: Shembuj lemash të fjalorit (gjermanisht)

Shembull (1)

I. {Artikelkopf – St.-Albanisch}:

kush int./rel./indef. prn. ‘wer’

II. {1. Überlieferung}: 1555

BuM 30vb: Ti kush je?; BuM 48ra: [...] përket muo me e dhanë, ma kuj të jetë dhanë ën Atit sim.; BuM 16rb: Përse ëndë mort s ashtë kush të bjerë ëndë mend për tÿ. [BD]

III. {Sprachgeographische Verbreitung}:

Über alle Regionen und Perioden verbreitet. [BD]

IV. {Formen: Paradigmatische Verhältnisse und Stammvariation}

A_G

m./f.sg.n	<i>kush</i>	BuM 68va; 32va; BuD ¹ 8 15; BoC ¹ I 2
m./f.sg.a	<i>kana</i> <i>kanāj</i>	BuM 21va; 38va; 55ra; 57vb BuD ¹ 66 25; BuR _I 25 07; BuR _{III} 128 17
m./f.sg.d./abl./g.	<i>kand</i> <i>(i/e/të) kuj</i> <i>kūj</i> <i>(të) kujnaj</i> <i>(të) kūjnaj</i>	BoC ¹ I 108; CuA 44 31; 55 5 BuM 22va; 38ra; BuR _I 306 26; BoC ¹ I 94; 106 BuR _I 106 4 BuM 21va; 22vb; BoC ¹ I 48 BuD ¹ 9 8; 55 6
(Substantiviert – auch alleinstehend – als attrib. Vorderglied einer NP)		
nt.sg.n.b.	<i>(të) kujtë</i>	BuM 81vb
m.sg.a.b.	<i>(të) kujët</i>	BoC ¹ I 74
m./f.sg.d.b.	<i>kujnajtë</i>	BuM 50va
m.sg.abl.b.	<i>(së) kujit</i>	BoC ¹ I 14; 112
m.pl.n.b.	<i>(të) kujëtë</i>	BoC ¹ I 175
f.sg.n.b.	<i>(e) kuja</i>	BoC ¹ I 59; 105; BoC ¹ II 89 BeK 99 3
f.sg.g.b.	<i>(së) kūjsë</i>	BuD ¹ 39 12
f.pl.n.b.	<i>(të) kūjatë</i> <i>(të) kujatë</i>	BuD ¹ 51 12 BoC ¹ I 117; BoC ¹ II 75

A_T

m./f.sg.n.	<i>kush</i>	BeK 98 12; 98 19; KaH 1 3
m./f.sg.a	<i>kë</i>	KaH 2 35; 4 71; 4 110; 5 93
m./f.sg.d./abl./g.	<i>kujt</i>	KaH 5 106; 24 34

A_{AR}

m./f.sg.n.	<i>kush</i>	MaD ¹ 5r 2; VaG 3
m./f.sg.a	<i>kë</i>	VaG 42; 55; 64
m./f.sg.d./abl./g.	<i>kūj</i>	VaG 20; 27; 53

[BD]

Anm.: Genusdifferenzierte und definite Wortformen dieses mehrfunktionalen Pronomens kommen grundsätzlich nur positionsbedingt als erstes Glied einer NP (oder stellvertretend für eine NP) vor, das, wie üblich, die grammatischen Marker für die gesamten al. NP auf sich trägt. (Sh. Demiraj GHGJSH 545ff.) [BD]

V. {Bedeutung}: 'wer' (nur auf Belebtes, d.h. auf Personen bezogen)

1. <Interrogativpronomen: fragt unmittelbar nach einer oder mehreren Personen>: BuM 12va: *Kush të ëmbahetë përpara faqesë ftofëtit tī?*; BuD¹ 126 12: *Prāshtu kush ashtë farmakuom me këtë mkat [...]?*; MaD¹ 38v 13: *Kush ishtë ndë mistirt shejt të kunkimit?*

<Interrogativ: kennzeichnet eine rhetorische Frage, auf die keine Antwort erwartet wird>: BuM 12rb: *Kush* anshtë porsì Zotynë Zot?; BoC¹ I 81: *Kush* është verbëtë, veçë shërbëtori em?

2. <Relativpronomen: bezeichnet in Relativsätzen, die sich auf Personen beziehen, diejenige Person, über die im Relativsatz etwas ausgesagt ist>: BuM 84/1ra: *Kush* do gjellënë e vet, aj ta bdjerë.; BoC¹ I 56: *Kush* kërkon të naltëtë, mbytetë ngushëllimesh.

3. <Indefinitpronomen: irgendjemand; jemand Besonderes>: BuM 21vb: E *kush* ëmbë këtë mëndyrë kâ fëjyem, fëjyem kâ [...]; MaD¹ 5r 6: E lum *kush* e kujton se kâ të vdesë.

[BD]

VI. {Idg. Rekonstrukt}:

Uridg. **k^uo-s + *so* ‚wer (ist) dieser‘ [OH]

VII. {Inneralbanische Rekonstruktion/Wortbildung}

Die lautliche Rekonstruktion von (a)alb. *kush* weist am ehesten auf eine unverbirte Satzstruktur uridg. **k^uos sos* im Satzsandhi oder uridg. **k^uos sos* in satzfinaler Stellung (Pausa-Stellung) hin, mit adjektivischem Interrogativum uridg. **k^uos* ‚welcher‘ (Klingenschmitt 2005: 358 Fn. 11, Hackstein 2004c: 276, Matzinger 2006: 72, 112) gegenüber substantivischem i-Stamm uridg. **k^uis* ‚wer‘ gefolgt vom Demonstrativum uridg. **so(s)*. Zur syntaktischen Unterscheidung von **so* (satzintern) und **sos* (in Pausa, d.h. am Satzende), s. Wackernagel KS I 176-178 und Strunk 1987: 328. Die in der Albanologie erwogene, alternative Rekonstruktion mit uridg. **k^uus* (s. die ältere Literatur bei Demiraj AE 228 und Topalli FEGJSH 847-848) empfiehlt sich nicht, da der interrogative u-Stamm, uridg. **k^uu-*, lokale Bedeutung besaß und keine personale. Im Albanischen entwickelte sich uridg. **k^uos =so* über voruralb. **kus=sa > *kuśśa* zu (a)alb *kush*, vgl. Schumacher/Matzinger VAABW 213, 264, mit lautlichem Übergang von **-o- > *-u-* im Wortauslaut vor alveolarem Frikativ -s wie in anderen indogermanischen Sprachen, vgl. aksl. -ŭ (vgl. Majer 2011, Olander 2012), lat. -us aus uridg. **-os*. Das Unterbleiben des uralb. Schwunds von postvokalischem **s* im absoluten Wortauslaut bei **k^uos* findet im Wortsandhi und der frühen Unverbirung des zugrundeliegenden uridg. **k^uos so* seine Begründung. [OH]

VIII. {Innersprachliche Derivation / Lehnquelle}

[.....]

IX. {Vergleichsmaterial im urindogermanischen Kontext und Feststellung der Grundform}

Die lautliche Rekonstruktion alleine erweist sich für die Rekonstruktion des alb. Interrogativum-Indefinitums *kush* als nicht hinreichend. Vielmehr bedarf es zur Motivierung der lautlich rekonstruierbaren Struktur uridg. **k^uos so* zusätzlich der syntaktischen Rekonstruktion. Der Sprachvergleich legt das Vorliegen einer erstarrten Satzstruktur nahe. Es handelt sich um die Petrifizierung eines Fokalsatzes ‚Welcher ist der?‘, generalisiert aus seinem häufigen Vorkommen entweder als selbständiger Interrogativsatz oder als extrafokaler Teil eines Spaltsatzes (cleft interrogative). Alb. *kush* konserviert in dem Fokalsatz uridg. **k^uos so* das syntaktische Merkmal des kopulalosen Nominalsatzes. Wh-cleft-Nominalsätze wurden über

prosodische Univerbierung, syntaktische Desententialisierung als neue komplexe Interrogativa morphologisiert. Derselbe Prozess wird auch durch aksl. *kŭto* und tocharisch B *kuse* (zu letzterem s. Hackstein 2001: 32–33) vorausgesetzt, und es gibt darüber hinaus viele weitere typologische Parallelen innerhalb und außerhalb des Indogermanischen, s. hierzu die Sammlung bei Hackstein 2004a: 348–356, Hackstein 2004b: 94–103, Hackstein 2004c: 267–283, Hackstein 2016/17: 225–227 sowie zum Armenischen Kölligan 2006: 113–119: uridg. **kʷos so(s)* > alb. *kush*, uridg. **kʷos tod?* > aksl. *kŭto*, uridg. **kʷis so(s)?* > toch. B *kuse* ‚wer, was‘ (Hackstein 2001: 32–33, vgl. frz. *qui est-ce qui ...?*), uridg. **kʷid tod* > aksl. *čŭto*. Die angenommene Univerbierung von Spaltsätzen aus Interrogativum und Demonstrativum erklärt zwei Anomalien, erstens die Beschränkung der Erweiterung des Interrogativstammes um den Demonstrativstamm auf den Nominativ, die aus der Funktion des Demonstrativum als nominativisches Prädikatsnomen folgt (s. Hackstein 2004c: 279), zweitens den Schwund des auslautenden **-s* des Interrogativstamms in **kʷos tod*, der **kʷos* als freie Form mit regulärem *s*-Schwund im absoluten Wortauslaut voraussetzt. Die freie Form ist noch im Indefinitpronomen aksl. *kŭ-žŭdo* fortgesetzt. Dieses geht möglicherweise auf (spät-)uridg. **kʷos ghido(r)* ‚who(ever) is wished, desired‘ (Majer 2012) zurück, welches „conserve l’ancienne forme du nom.sg. *kŭ* (<**kʷos*)“ (Le Feuvre/Petit 2009: 77). Der vorausgesetzte syntaktische Typ des univerbierten Fokalsatzes und seiner Verallgemeinerung als komplexes Interrogativum ist noch im Lateinischen, Altgriechischen, Tocharischen, Altarmenischen (zu letzterem Kölligan 2016: 117–119) und biblischem Hebräischen belegbar. So ist z.B. uridg. **kʷis so* wie durch tocharisch B *kuse* vorausgesetzt in gr. *tis d’hóde Nausikáai hépetai?* ‚Wer aber (ist) dieser [der] der Nausikaa folgt?‘ (Hom. Od. 6,276) belegt. Des Weiteren wird uridg. **kʷid tod* wie durch aksl. *čŭto* vorausgesetzt in gr. *tí tout’ enóēsen alētēs?* ‚Was [ist] das [, was] der Wanderer bemerkt hat?‘ (Hom. Od. 17,576) belegt. Vgl. ähnlich auch uridg. **kʷid kʷod* in lat. *Quid quod sapientissimus quisque aequissimo animo moritur ...?* ‚Was [ist damit], das(s) gerade die Klügsten mit größtem Gleichmut sterben ...?‘ (Cic. de Senect. 23,83). [OH]

X. {Literatur}

Tagliavini AD 165; Pok. 647: St. **kwu-*; Çabej SGJ I 302f. **kwu-so-*, vgl. toch. B. Interrogativ./Relativpron. *kuse*; Huld BAE 84; Orel Sprache 31 [1985] 280; LB 30 [1987] (1) 58f.

XI. {Querverweise}:

↑ QYSH, ↑ KU, ↑ KUND, ↑ KUR

XII. {SIGLE DES VERFASSERS}: [BD], [OH]

Shembull (2):

I. {Artikelkopf - St.-Albanisch}:

kórdh[ë] -a I sf.sg.unb./b. ‚Schwert, Säbel‘ FGJSSH 869

II. {1. Überlieferung – 1555}:

BuM 64va: Ju duoltë pors i ëmbë një kusār, me armë e me tojaga e me *kordhë*, me më zanë... (tamquam ad latronem existis cum gladiis et fustibus comprehendere me) (Mt 26 55) [BD]

III. {Sprachgeographische Verbreitung}

Das Wort ist in A_G nur bei Buzuku belegt; es kommt jedoch in A_T und A_{AR} bei mehreren Autoren vor, was die Annahme einer überregionalen Verbreitung in der aal. Schriftkultur nahelegt.

Anm.: Zweifel bei Çabej SE V 124, der hier eher für die Bedeutung ‘Strick, Seil’ plädiert und das Wort unter (↑) *kordhë* II ‘Violinsaite aus Darm; Darmseil’ behandelt. [BD]; [AO]

IV. {Morphologie: Paradigmatische Verhältnisse und Stammvariation}

A _G		
Morphol.	Beispiel	Sigle + Fundstelle
Formmerkmale		
f.sg.unb.	<i>kordhë</i>	BuM 64va
A _T		
f.sg.acc.unb.	<i>kordhë</i>	BeK 79 4; FrL 55 22
f.sg.n.b.	<i>kordha</i>	BeK 99 26
A _{AR}		
f.sg.acc.unb.	<i>kordhë</i>	ChAIV IV 7
f.sg.n.b.	<i>kordha</i>	ChL 219
m.pl.n./acc.unb.	<i>kordhënë</i>	ChC IB 84

[BD]

V. {Bedeutung}: ‘Schwert, Säbel’

1. <Schwert, Säbel>: BuM 64va : ...e me atë gjind e madhe me tojaga e me armë e me *kordhë*... (et cum eo turba multa, cum gladiis et fustibus) (Mt 26 47); BeK 99 26: *kordha* ‘σπάθη’; DaM 633: Edhe *kordha* pret njerinë; ChL 219: *kordha* ‘scimitarra, sablia’.

2. <Herrschaft; Joch>: FrL 55 22: ... më ke nënë *kordhë*.

[BD]

VII. {Herkunftsbestimmung}

Miklosich AF I 22 und Meyer EWA 199 sehen hier eine Entlehnung aus einer südsl. Basis, die u.a. aslow. *kor̃da*, skr. *kôrda* ‘Säbel, Schwert’, des Weiteren pol. *kord* etc. zugrunde liegt. Zustimmung bei Weigand ADDAW 38, Berneker I 569, Çabej SE V 124, Topalli FEGJSH 800 etc. Der Übergang (asl.) *d → aal. *ð im Inlaut (Demiraj AE 62) sowie die sprachgeographische Verbreitung deuten auf eine ältere Zeitstufe der Entlehnung hin: aus altbulg. **kor̃da* ‘Schwert’ (Vasmer REW I 624: türk. Lehnwort). [AO]

X. {Literatur}

Miklosich AF I 22, Meyer EWA 199, Weigand ADDAW 38, Berneker I 569, Vasmer REW I 624, Ylli 1997: 129, Orel AED 191, Çabej SE V 124, Topalli FEGJSH 800.

XII. {Sigle des Verfassers}: [BD]; [AO]

Rexhep Ismajli

Kosovë

Idetë për prejardhjen e gjuhës shqipe dhe të shqiptarëve në Jugosllavi

Brenda suazave të një kumtese do të merrem me nyjëtimet kryesore të çështjeve të prejardhjes së gjuhës shqipe dhe të popullit shqiptar duke mbajtur parasysh faktin se interesi për studimin e çështjes së prejardhjes së gjuhës shqipe në Jugosllavi kishte qenë i hershëm dhe ishte nxitur sidomos pas themelimit të mbretërisë serbe-kroate-slllovene/Jugosllavisë: më 1924 u themelua nga H. Barić në Beograd Seminari Albanologjik, u botuan në tri vëllime të *Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju* (vëllimi i katërt doli me rastin e ribotimit të tri të parëve më 1969 në Prishtinë) dhe një sërë librash, pastaj pati një heshtje. Seminari kishte një kohë dhe lektor shqiptar – Xhevat Korça, e pastaj Vojislav Dančetović. Të ndërlidhura qenë dhe veprimtaritë rreth studimeve ballkanike me *Révue des études sud-est européennes et balkaniques* 1937- (Petar Skok në Zagreb, Milan Budimir në Beograd). Seminari albanologjik gjatë LDB-së nuk funksionoi, pas saj më 1948 në horizontin e Jugosllavisë së re, Barić, si i dënuar politikisht nga gjyqi i nderit i Universitetit të Beogradit, nuk mundi të ishte më atje. Ai një kohë pati angazhime në Zagreb e Sarajevë, ku më vonë themeloi Institutin Ballkanologjik. Në Beograd, në krye të Seminarit Albanologjik erdhi V. Dančetović, i cili nuk e kishte staturën prej komparatisti, indoeuropeisti, albanologu, romanisti e sllavisti të Henrik Barić-it, por mund të kishte njohuri praktike për shqipen, ndërsa si asistent u angazhua Anton Çetta, lektor Idriz Ajeti. Më 1953 në Prishtinë u themelua Instituti Albanologjik me Selman Rizën, por u mbyll më 1955 (Riza u dëbua në Shqipëri). Pas vitit 1960 u hapën studimet për gjuhën dhe letërsinë shqipe në Prishtinë, e pas ndryshimeve të vitit 1966, më 1967 u rithemelua Instituti Albanologjik me drejtor Fehmi Aganin. Përveç Henrik Barić-it, kroat nga Dubrovniku, i formuar në Graz e Vjenë, e Vojislav Dančetović-it nga Vushtrria, në tërë